

KALENDARI NGRITJA E KAMPIONEVE PER BURRA SHKURT 2023

1. Perëndia i kësaj epoke – Bibla bën një dallim të qartë midis krijuesit tonë Perëndisë dhe të ligut që mbretëron në këtë botë dhe kërkon adhurimin e njerëzve. “Perëndia i këtij shekulli ua verboi mendjet e atyre që nuk besojnë.” (2 Kor 4:4). Lutuni që Perëndia të largojë këtë verbëri nga sytë e anëtarëve tuaj të familjes që nuk e njohin ungjillin.

2. Shoqëritë – “Mos u gënjeni; shoqëritë e këqija prishin zakonet e mira.” (1 Kor 15:33). Presioni i shoqërisë mund të jetë një armik i madh i fëmijëve dhe njerëzve që varen tek aprovimi i të tjerëve. Miq, kërkonte së pari mbretërinë e Perëndisë dhe shpejt ju do të njiheni si një person që e do Zotin dhe që bekon ata që janë në shoqërinë tënde.

3. Trajnimi – Fëmijët janë si çimento e njomë, vulnerabël dhe lehtësisht të konformueshëm me mësimin me të cilin rriten. “Mësoji fëmijës rrugën që duhet të ndjekë, dhe ai nuk do të largohet prej saj edhe kur të plakët.” (Fjalët e Urta 22:6). Bëhuni një burrë i Zotit dhe ndani me fëmijët tuaj të vërtetën e Tij në dashuri. Ata kanë nevojë për drejtim në një botë që mohon parimet biblike.

4. Dorëzohuni – “Biri im, më jep zemrën tënde, dhe sytë e tu gjetshin gëzim në rrugët e mia” (Fjalët e Urta 23:26). Perëndia nuk kërkon asgjë më shumë sesa dorëzimin total të zemrave tuaja. Nuk ka një rrugë të mesme. Burra, jini radikalë dhe mos i lejoni lëshime mëkatit. Me përlësi rrëfeni nevojën tuaj për faljen e Tij dhe rikthimin e hirit. Perëndia dëshiron t’ju përdorë ju.

5. Transplant – “Sepse nga zemra dalin mendimet e mbrapshta, vrasjet, shkeljet e kurorës; kurvëria, vjedhjet, dëshmitë e rreme, blasfemitë.” (Mt 15:19). Çdo burrë ka nevojë për një transplant zemre. Kjo është arsyeja pse Jezusi erdhi në këtë botë; për të kërkuar dhe për të shpëtuar atë që është i humbur. Nëse tashmë je dishepulli i tij; sill një ndryshim; drejtoji të tjerët tek Shpëtimtari.

6. Mosbindje – “Në fakt, ashtu si nga mosbindja e një njeriu të vetëm të shumtët u bënë mëkatarë...” (Rom 5:19a). Adami është përgjegjës për rënien e të gjithë njerëzimit. Ne jemi pasardhësit e tij dhe kemi lindur si mëkatarë, të ndarë nga një Zot i shenjtë. Prano mosbindjen tënde dhe rrëfe mëkatin tënd. Krishti dëshiron të jetë shpenguesi yt.

7. Bindje – “...ashtu edhe nga bindja e një të vetmi të shumtët do të bëhen të drejtë.” (Rom 5:19b) Jezus Krishti, Biri i Perëndisë lindi si Adami i fundit në këtë botë. Përmes bindjes, ai u bë e përsosura sakrificë dhe pagoi në kryq për mosbindjen e Adamit. Besoni në të dhe ju do të bëheni të drejtë.

8. Të lindur sërish – “Në të vërtetë, në të vërtete po të them që nëse një nuk ka rilindur, nuk mund ta shohë mbretërinë e Perëndisë.” (Gjon 3:3). Shpengimi i vërtetë i fesë është iniciativa e Zotit. Ai dëshiron t’i japë një zemër të re, një jetë të re dhe të përjetshme, atij që beson në Birin e Tij, Jezus Krishtin. Nëse ju besoni ai do t’ju japë një zemër të re, tek e cila Zoti mbretëron me dashurinë dhe fuqinë e Tij.

9. Identitet – “Unë jam hardhia, ju jeni shermendet; kush qëndron në mua dhe unë në të, jep shumë fryt, sepse pa mua nuk mund të bëni asgjë.” (Gjon 15:5). Një degë që jep fryte nuk është kurrë e pavarur. Ajo ka një marrëdhënie të gjallë dhe organike me hardhinë dhe kështu keni dhe ju nëse jeni një besimtar në Krishtin. Atëherë jetoni identitetin tuaj të ri; ju jeni një fëmijë i Perëndisë.

10. Fryte – Është shumë e lehtë të dish nëse drejtohesh nga Fryma e Zotit ose nëse ti vepron sipas mënyrës tënde të vjetër. Jini një burrë i vërtetë, kurajoz dhe i përlur. Kërkojini anëtarëve të familjes të shohin nëse Fryma e Perëndisë punon në ju. “Por fryti i Frymës është: dashuria, gëzimi, paqja, durimi, mirëdashja, mirësia, besimi, zemërbutësia, vetëkontrolli.” (Gal 5:22).

11. I zgjedhur - “Oh Zot, ndonjëherë nuk e imagjinoj dot të më dojë njeri, por Ti më do mua! Për shkak të dashurisë Tënde, Ti më ke zgjedhur. Ti më ke zgjedhur të jem “në Krishtin”, në mënyrë që të ishim sëbashku. Falemnderit Zot që më ke lejuar të pranoj Krishtin. Jam mirënjohës për prezencën tënde që banon në mua. (Efes 1:4)

12. I adoptuar - “Falem nderit Zot që më ke përfshirë në familjen tënde! Edhe pse isha një fëmijë i korruptuar nga djalli, ti më adoptove. Ti më bashkove me veten dhe më bërë një fëmijë të Perëndisë. Falemnderit që je një At Qiellor kaq i dashur.” (Efes 1:5)

13. Një sakrificë e gjallë - “I dashur Zot, e vetmja mënyrë si mund të shërbej Ty është duke ta dhënë veten time ty. Duke qenë se ti di atë që është më e mira për mua, me kënaqësi e paraqes trupin tim tek Ti si një enë e disponueshme. Të ftoj Ty të banosh në mua dhe të rrish si në shtëpinë tënde dhe të bësh rrugën tënde në mua. Jam i nderuar të jem një sakrificë e gjallë për ty.” (Rom 12:1)

14. Perëndia i së pamundurës- “Oh Zot, kaq shumë gjëra duken të pamundura për mua, por kur të shoh ty dhe mrekullinë e lindjes së Jezusit, e kuptoj se asgjë nuk është e pamundur për ty në jetën time. Më ndihmo të përgjigjem ty me bindje të menjëhershme. (Luka 1:37-38)

15. Adhures të vërtetë - “I dashur Zot, si sunduesi sovran i universit, vetëm Ti je i denjë për t’u adhuruar. Unë dëshiroj të adhuroj Ty, jo vetëm me fjalë por edhe me vepra. Prandaj, e dorëzoj veten time tek Ty që të punosh përmes meje. Më ndihmo t’i bindem nxitjes së Frymës tënde dhe të lavdëroj Ty me të gjithë jetën time.” (Mt 2:1-2, 13-14)

16. Lutja – “Shumë fuqi ka lutja e të drejtit kur bëhet me gjithë shpirt.” (Jakobi 5:16b). A është zemra ime e fokusuar për të kënaqur Zotin? Nëse po, atëherë mund të lutem me besim duke e ditur se Zoti do të përgjigjet dhe do të bëjë atë që është më e mira për mua.

17. Të duash Zotin – “Duaje Zotin, Perëndinë tënd, me gjithë zemër, me gjithë shpirt dhe me gjithë mendjen tënde” (Mt 22:37). Jetët tona reflektojnë atë se çfarë apo kë duam. Nuk ka asgjë më të rëndësishme dhe më shpërblyese në jetë sesa të

duash Zotin me fjalë dhe me vepra. Kjo sjell gjithë ndryshimin dhe çon në një jetë të mirë dhe të përmbushur.

18. Duaje të afërmin tënd – “Duaje të afërmin si vetja” (Mt 22:39). Nga dashuria e Perëndisë rrjedh dashuria për të afërmit tanë. Pikërisht kështu jeta jonë gjen përmbushje të vërtetë. – A je gati të bësh pyetjen se kush është i afërmi yt dhe si mund t’i tregosh dashuri dhe mirësi atij?

19. Paratë dhe zotërimet – “në rast se pasuritë janë të bollshme, mos u kushtoni zemrën” (Ps 62:10b). Paratë dhe zotërimet na besohen nga Perëndia në mënyrë që t’i shijojmë dhe të jemi administratorë të mirë të tyre. Ndërsa keni mundësinë t’u bëni të mira të tjerëve bekimi i Zotit do të jetë në shtëpinë tuaj.

20. Qëllim hyjnor - “Pastaj Perëndia tha: “Ta bëjmë njeriun Ta bëjmë njeriun sipas shëmbëlltyrës sonë dhe në ngjasim me ne’... Ai krijoi mashkullin e femrën. Pastaj Zoti Perëndi ... formoi një grua dhe e çoi te njeriu” (Zan. 1:26.27; 2:22). Burri i vërtetë e pranon seksualitetin e tij si një dhuratë nga Perëndia për t’i shprehur dashurinë e tij ndihmëses që Zoti i ka dhënë.

21. Motivët e duhura – Kur ne i ofrojmë ndihmë njerëzve, ne nuk duhet të presim asgjë në kthim. Lutuni që Zoti do t’ju ndihmojë t’u shërbeni të tjerëve me motive të pastra, duke pritur shpërblimin nga Zoti (1 Pjet.5:2)

22. Të mprehtë dhe të pafajshëm – Kur Perëndia ofron mundësi për të dëshmuar për Krishtin, ne duhet ta bëjmë këtë me entuziazëm dhe pa frikë. Lutuni që Perëndia t’ju ndihmojë, si një ambasador i mbretërisë së Tij, të jeni mendjemprehtë si një gjarpër dhe të pafajshëm si një pëllumb në një botë që është armiqësore ndaj Ungjillit (Mateu 10:16).

23. Agape – Zoti na do më shumë seç mund ta kuptojmë. Dashuria e tij hyjnore që ka emrin grek "Agape", është forma më e lartë e dashurisë dhe e motivoi Jezu Krishtin të na shpengojë në kryq. Falenderojeni sot për dashurinë dhe dhembshurinë e tij për ju (Gjoni 3:16).

24. Philia – Ne kurrë nuk mundemi, nga burimet tona, të duam siç do Perëndia. Megjithatë, përgjigja jonë duhet të jetë t’i duam vëllezërit dhe motrat tona. Fjala greke për dashurinë e miqësisë është "Philia". Por Perëndia do t’ju ndihmojë të bëni më mirë dhe të tregoni dashuri dhe dhembshuri ndaj bashkëbesimtarëve tuaj ashtu siç ju do. (1 Gjonit 4:11).

25. Faqe e bardhë – Kur i japim jetën Jezu Krishtit, ai na fal të kaluarën dhe na bën një krijim të ri. (2 Kor 5:17) Nëse keni sjellë në martesë kujtime të dhimbshme e torturuese, dorëzoni Jezusit dhe falni njëri-tjetrit! Asgjë nuk është shumë e dëmshme që Ai nuk mund ta rivendosë. Kërkojini Zotit të sjellë gëzim të ri në marrëdhënien tuaj.

26. Themeli - Çdo ndërtesë ka nevojë për një themel të fortë për të qëndruar. Një jetë e suksesshme bazohet në “të duash Zotin, Perëndinë tënd, me gjithë zemrën

tënde, me gjithë shpirtin tënd dhe me gjithë forcën tënde”. (Lip. 6.5) Lutuni që ta keni këtë themel në jetën tuaj dhe të ndërtoni familjen tuaj mbi këtë themel.

27. Durimi– Durimi është pjesë e frytit të Frymës së Shenjtë dhe rekomandohet disa herë në Dhiatën e Re (Gal. 5.22; Efes. 4.2; Kol 1.11). Mësoni si të kontrolloni emocionet tuaja, në shtëpi, me fëmijët, në punë dhe në raste të tjera. Është një demonstrim i llojit të marrëdhënies që keni me Zotin! - Zot, më ndihmo të jem i durueshëm!

28. Ushqimi - Bibla është Fjala e Perëndisë, është burimi që ushqen dashurinë tonë për Jezusin. Kur një njeri ka kohën e tij të përditshme të përkushtimit duke lexuar, medituar mbi Biblën dhe duke u lutur, rezultati është një zemër e forcuar dhe e udhëhequr nga vullneti i Perëndisë. Lutuni që asgjë të mos ndërhyjë në marrëdhënien tuaj me Zotin. (Fjalët e urta 8,17).